



Republika e Kosovës/ Republika Kosova
Republic of Kosovo
Komuna Istog/ Opstine Istok/ Municipality of Istog
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



12 Nr.16/2025
Datë: 03.03.2025

THIRRJE PUBLIKE – KATEGORIZIMI I KLUBEVE SPORTIVE

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport bazuar në Rregulloren Komunale për Kategorizimin e Klubeve Sportive me nr.01-179/2024 të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Istogut, njofton të gjitha Klubet Sportive të regjistruara në Komunën e Istogut të aplikojnë për Katagorizim të Klubeve Sportive.

Vlera totale e planifikuar për Kategorizim të Klubeve Sportive është 40.000 euro.

Aplikimi bëhet duke plotësuar formularët përkatës me të dhënat e klubit tuaj, rezultatet si dhe të dhënat tjera që parashihen me rregullore. Poashtu duhet bashkangjitur dëshmitë nga Federatat përkatëse për secilën pikë të plotësuar në formular në mënyrë që aplikimi juaj të jetë i kompletuar.

Rregulloren Komunale për Kategorizimin e Klubeve Sportive dhe formularët ku i keni të gjitha informatat e duhura për aplikim i gjeni të bashkangjitura me njoftim.

Formularët e plotësuar së bashku me dëshmitë përkatëse në zarf të nbyllur dorëzohen në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve (kati i I-rë zyra nr.100), drejtuar Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Afati për aplikim: **03.03.2025 – 17.03.2025**

Nëse klubet dorëzojnë formularin dhe dokumentacionin përkatës me vonesë, ose dëshmitë e bashkangjitura nuk janë ashtu si kërkohet në Rregullore, aplikimi nuk pranohet dhe klubi nuk kategorizohet.

Për informata shtesë dhe për çdo paqartësi drejtoheni në Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoresha: *V. P. Duka*

